

IDRO POWER SERVICE sh.p. k

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

Së bashku me raportin e Audituesit të Pavarur

mazars

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7-25

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakun e Shoqërisë "Idro Power Service" sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë "Idro Power Service" sh.p.k (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2021, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2021, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat financiare të konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijmësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuideojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.


Emin Duraku Str.
No.5, 1013, Tirana, Muzet
NUIB: K32123006W

30 mars 2022

Diana Ylli (Golemi)
Auditues Ligjor

Idro Power Service sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2021**

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	939,273	2,471,942
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	134,529	3,464
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	45,664,952	56,809,146
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	16,781	2,962,859
Inventarë	8	5,372,900	4,668,977
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	2,211,705	384,235
Totali i aktiveve afatshkurtra		54,340,140	67,300,623
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	10	6,737,571	8,520,294
Totali i aktiveve afatshkurtra		6,737,571	8,520,294
Totali i aktiveve		61,077,711	75,820,917
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	11	16,725,331	4,660,535
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	145,408	20,148,943
Detyrime tatimore	13	4,941,752	6,225,437
Të tjera detyrime	14	1,457,543	1,065,542
Totali i detyrimeve afatshkurtra		23,270,034	32,100,457
Detyrime afatgjatë			
Totali i detyrimeve afatgjatë		-	-
Totali i detyrimeve		23,270,034	32,100,457
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		1,500,000	1,500,000
Rezerva ligjore		150,000	150,000
Rezerva të tjera		12,070,460	23,658,306
Fitimi i ushtrimit		24,087,217	18,412,154
Totali i kapitalit	15	37,807,677	43,720,460
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		61,077,711	75,820,917

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Idro Power Service sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	136,153,837	84,498,319
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	17	(185,099)	(251,770)
Total të ardhura		135,968,738	84,246,549
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(85,650,891)	(43,751,280)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme	18	(78,623,696)	(38,574,147)
2) Të tjera shpenzime	19	(7,027,195)	(5,177,133)
Shpenzime të personelit	20	(20,016,251)	(16,114,143)
1) Paga dhe shpërblime		(18,120,748)	(14,456,586)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(1,895,503)	(1,657,557)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(1,699,321)	(1,925,565)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	21	(804)	(4,112)
Shpenzime financiare		-	(590,657)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	22	-	(338,157)
2) Shpenzime të tjera financiare	23	-	(252,500)
Fitimi/humbja para tatimit		28,601,471	21,860,792
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(4,514,254)	(3,448,638)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	24	(4,514,254)	(3,448,638)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		24,087,217	18,412,154
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		24,087,217	18,412,154

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Idro Power Service sh.p.k
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021


	Kapitali i nënshkruar				Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 01 janar 2020	1,500,000	150,000	55,269,581	30,388,725	87,308,306			
Rezerva ligjore dhe të tjera	-	-	30,388,725	(30,388,725)	-	-	-	
Fitimi i vitit	-	-	-	18,412,154	18,412,154		18,412,154	
Dividenti	-	-	(62,000,000)	-	(62,000,000)		(62,000,000)	
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	1,500,000	150,000	23,658,306	18,412,154	43,720,460			
Rezerva ligjore dhe të tjera	-	-	18,412,154	(18,412,154)	-	-	-	
Fitimi i vitit	-	-	-	24,087,217	24,087,217		24,087,217	
Dividenti	-	-	(30,000,000)	-	(30,000,000)		(30,000,000)	
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021	1,500,000	150,000	12,070,460	24,087,217	37,807,677			

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faja 7 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 janë aprovuar nga administratori i Idro Power Service sh.p.k më 28 mars 2022 dhe janë firmosur si më poshtë.

Giordano Gorini
Administrator


IDRO POWER SERVICE SH.P.K.
Rr. Vërditë, Nr. 1, P. Bujakët
Tirana, Shqipëri


Nexhmije Saraçi
Financiere

Idro Power Service sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
<i>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</i>		
Fitim / Humbja e vitit	24,087,217	18,412,154
Shpenzimet financiare jomonetare	123,277	349,016
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	1,699,321	1,925,565
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	(165,462)	-
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	15,353,358	56,529,884
Rënie/(rritje) në inventarë	(703,923)	2,531,937
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	(1,827,470)	-
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(9,222,423)	921,284
Tatim mbi fitimin e paguar	(1,394,151)	(3,461,396)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	392,001	254,001
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	28,341,745	77,462,445
<i>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/ (përdorur në) aktivitetin e investimit</i>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(344,561)	(1,375,074)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	593,424	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	248,863	(1,375,074)
<i>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/ (përdorur në) aktivitetin e financimit</i>		
Pagesa e huave	-	(12,682,000)
Interes i paguar	-	(338,157)
Dividendë të paguar	(30,000,000)	(62,000,000)
Mjete monetare neto nga/ (përdorur në) aktivitetin e financimit	(30,000,000)	(75,020,157)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(1,409,392)	1,067,215
Mjetet monetare në fillim të periudhës	2,471,942	1,415,586
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit	(123,277)	(10,859)
Mjetet monetare në fund të periudhës	4 939,273	2,471,942

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Idro Power Service sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Idro Power Service" Sh.p.k është krijuar më 24/07/2017 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" dhe nga statuti i saj.

Kapitali i Shoqërisë është 1,500,000 lek. "Idro Power Service" sh.p.k është një shoqëri shqiptare me ortakë:

- Giordano Gorino - zotëron 10% të pjesëve të kapitalit
- Hydra Energia - zotëron 90% të pjesëve të kapitalit

Administrator i Shoqërisë është z. Giordano Gorini për periudhën nga 24/07/2017 deri në 24/07/2022.

Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr 5, Rruga Emin Duraku, Pallati "Binjakët", Nr 5.

Ajo është regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore të rrethit Tiranë me NIPT L71926004C.

Aktiviteti kryesor i kësaj Shoqërie është prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë elektrike; projektimi, ndërtimi i centraleve për prodhimin e energjisë elektrike; furnizimi i shërbimeve me asistencë teknike, mirëmbajtje dhe riparim të të gjitha makinerive dhe pajisjeve, duke përfshirë asistencën teknike, mirëmbajtjen e riparimin e cdo lloj ndërtese; kërkimi dhe zhvillimi i sistemeve për të përmirësuar prodhimin, trainime profesionale dhe për menaxhim, në favor të personelit, të bashkëpunëtorëve në interes të nevojave të Shoqërisë; pjesëmarrja në programe ndërkombëtare për bashkëpunim dhe partnership me kompani dhe operatorë të KE për të implementuar programe specifike. Import-eksport, tregtimi me pakicë dhe shumicë i makinerive, pajisjeve, aparaturave dhe mallrave në lidhje me kryerjen e aktivitetit të Shoqërisë. Konsulencë teknike, administrative, menaxhuese dhe të cdo lloji natyre tjetër të lidhur me objektin e Shoqërisë.

Në 31 dhjetor 2021 shoqëria ka 11 punonjës (2020: 11).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar (SKK) dhe ligjin nr. 25/2018 datë 30 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrin nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuar dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%. Në të tilla raste Shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
EUR/LEK	120.76	123.7
USD/LEK	106.54	100.84

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë për llogaritë mbi bazën e interesit nominal.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proçes" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Instrumenta dhe vegla	Vlera e mbetur	20 %
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5 %

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të

minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 është 15% (2020: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

Idro Power Service sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13 Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Mjete monetare në bankë	935,435	2,466,944
Në Lekë	935,435	2,466,944
Mjete monetare në arkë	3,838	4,998
Në Lekë	3,838	4,998
	<u>939,273</u>	<u>2,471,942</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Klientë	134,529	3,464
	<u>134,529</u>	<u>3,464</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Klientë për palë të lidhura	45,664,952	56,809,146
	<u>45,664,952</u>	<u>56,809,146</u>

Idro Power Service sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në Lek)

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Dogana	16,781	8,991
Tatim fitimi	-	2,953,868
	<u>16,781</u>	<u>2,962,859</u>

8. Inventarë

Inventarët më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Materiale të para	5,194,973	4,505,465
Materiale ndihmëse	9,194	1,713
Lëndë djegëse	168,733	161,799
	<u>5,372,900</u>	<u>4,668,977</u>

9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Shpenzime të shtyra	234,814	384,235
Paradhenie	1,976,891	-
	<u>2,211,705</u>	<u>384,235</u>

Idro Power Service sh.p.k
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
 (Vlerat janë në Lek)

10. Aktive afatgjata materiale

	Instrumenta dhe veçia pune	Mjete transporti	Pajisje informatike	Të tjera	Totali
Kosto					
Gjendja më 1 janar 2020	3,015,094	8,582,243	743,885	27,158	12,368,380
Shtesa	1,375,074	-	-	-	1,375,074
Gjendja më 31 dhjetor 2020	4,390,168	8,582,243	743,885	27,158	13,743,454
Shtesa	177,894	-	166,667	-	344,561
Pakësime	-	(926,450)	-	-	(926,450)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	4,568,062	7,655,793	910,552	27,158	13,161,565
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 1 janar 2020	770,855	2,453,416	72,420	905	3,297,596
Amortizimi i vitit	526,682	1,225,765	167,867	5,251	1,925,565
Gjendja më 31 dhjetor 2020	1,297,537	3,679,181	240,287	6,156	5,223,161
Amortizimi i vitit	631,145	906,826	157,150	4,200	1,699,321
Pakësime	-	(498,488)	-	-	(498,488)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	1,928,682	4,087,519	397,437	10,356	6,423,994
Vlera neto kontabël					
Gjendja më 31 dhjetor 2020	3,092,631	4,903,062	503,598	21,002	8,520,294
Gjendja më 31 dhjetor 2021	2,639,380	3,568,274	513,115	16,802	6,737,571

Idro Power Service sh.p.k**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021***(Vlerat janë në Lek)***11. Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Furnitorë brenda vendit	16,142,286	4,534,622
Furnitorë jashtë vendit	548,139	67,674
Furnitorë për fatura të pambërritura	34,906	58,239
	<u>16,725,331</u>	<u>4,660,535</u>

12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Hydra Energia s.r.l	28,631	29,324
Giordano Gorini	116,777	119,619
Detyrime per dividend Hydra Energia srl	-	18,000,000
Detyrime per dividend Giordano Gorini		2,000,000
	<u>145,408</u>	<u>20,148,943</u>

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	275,129	253,363
Tatim mbi të ardhurat personale	421,499	371,869
TVSH për tu paguar	4,021,591	1,389,838
Tatimi në burim	57,298	4,210,367
Tatim Fitimi	166,235	-
	<u>4,941,752</u>	<u>6,225,437</u>

Idro Power Service sh.p.k**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021***(Vlerat janë në Lek)***14. Të tjera detyrime**

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Paga dhe shpërblime	1,457,543	1,065,542
	<u>1,457,543</u>	<u>1,065,542</u>

15. Kapitali

Struktura e kapitaleve të veta paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>			<u>31 dhjetor 2020</u>		
	Nr i pjesëve	Vlera e kapitalit	Në %	Nr i pjesëve	Vlera e kapitalit	Në %
Hydra Energia	1	1,350,000	90%	1	1,350,000	90%
Giordano Gorini	1	150,000	10%	1	150,000	10%
	<u>2</u>	<u>1,500,000</u>	<u>100%</u>	<u>2</u>	<u>1,500,000</u>	<u>100%</u>

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerë 1,500,000 lekë.

Fitimi i ushtrimit

Shoqëria ka fitim më 31 Dhjetor 2021 prej 24,087,217 LEK (2020: 18,412,154 LEK).

16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Shërbime monitorimi dhe konsulence	16,457,616	14,911,900
Shërbime mirëmbajtjeje	62,243,133	35,858,593
Shërbime punimesh	57,453,088	33,727,826
	<u>136,153,837</u>	<u>84,498,319</u>

16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>31 dhjetor 2021</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	136,153,837
Të ardhura nga shitja materiale paraqitur te të ardhurat e tjera	593,424
Shuma e qarkullimit	<u>136,747,261</u>
Të ardhura që nuk deklarohen në shitje në FDP e TVSH-së	
Të ardhura nga diferencat e kursit përfshirë per neto në zërin "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit"	227,072
Të ardhura total sipas Kontabilitetit	136,974,333
Të ardhura total deklaruar në FDP e TF	<u>136,974,333</u>
Diferenca	<u>-</u>

17. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar. Ato detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Fitim nga këmbimet valutore	227,072	22,558
Humbje nga këmbimet valutore	(577,633)	(305,578)
Të ardhura nga shitje materiale	-	31,250
Rezultati Neto nga shitja e AAM	165,462	-
	<u>(185,099)</u>	<u>(251,770)</u>

Dalja jashtë përdorimit dhe shitja e aktiveve afatgjata materiale

Të ardhura nga shitja e AAM	593,424	-
Shpenzime nga shitja e AAM	(427,962)	-
Rezultati Neto nga shitja e AAM	<u>165,462</u>	<u>-</u>

18. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Kosto e materialeve të konsumuara	28,460,306	15,459,793
Konsulencë teknike	611,355	291,995
Nënkontraktorët	42,991,248	18,154,086
Shpenzime udhëtimi dieta	2,675,700	2,075,867
Shpenzime transporti	2,324,384	1,120,000
Qira Magazine	705,888	705,888
Primi sigurimit	854,815	766,518
	78,623,696	38,574,147

19. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Konsulencë ekonomike- juridike	1,392,195	1,414,125
Taksa vendore e të tjera	534,842	388,424
Shpenzime të ndryshme	848,929	510,569
Sherbime bankare	226,224	181,491
Mirembajtje dhe riparime	2,599,798	1,862,700
Sherbime per pritje percjellje	89,280	78,600
Qira automjeti	50,231	6,200
Shpenzime administrative	19,400	31,167
Shpenzime telefon, internet	366,214	101,930
Primi sigurimit	110,025	140,654
Shpenzime transporti	48,500	13,000
Shpenzime udhëtimi dieta	741,557	448,273
	7,027,195	5,177,133

20. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Shpenzime paga	18,120,748	14,456,586
Shpenzime për sigurime shoqërore	1,895,503	1,657,557
	<u>20,016,251</u>	<u>16,114,143</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2021 është 11 (2020: 11).

21. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Shpenzime gjoba dhe penalitete	804	4,112
	<u>804</u>	<u>4,112</u>

22. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit të shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Shpenzime interesi dhe të ngjashme	-	338,157
	<u>-</u>	<u>338,157</u>

23. Shpenzime të tjera financiare

Shpenzimet te tjera financiare përfshijnë rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Humbje nga këmbimet valutore	-	252,500
	-	252,500

24. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit në 2021 është 15% (2020: 15%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruar për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Në përcaktimin e rezultatit tatimor Shoqëria ka marrë në konsideratë shpenzimet e panjohura për efekte fiskale. Ato lidhen me:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
<i>Fitimi para tatimit</i>	28,601,471	21,860,792
Total shpenzime të panjohura	1,493,557	1,130,130
Gjoha dhe penalitete	804	4,112
Shpenzime për pritje dhe përfaqesime	-	78,600
Shpenzime të tjera	1,492,753	1,047,418
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	30,095,028	22,990,922
<i>Tatim fitimi @15%</i>	4,514,254	3,448,638
	24,087,217	18,412,154

Idro Power Service sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në Lek)

25. Transaksionet me palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura përfaqësojnë transferim të burimeve, shërbimeve, ose detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse vendoset apo jo një çmim. Një palë e lidhur është një palë, e cila kontrollon, kontrollohet, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë tregtare, ka një interes mbi njësinë që i jep një influencë të rëndësishme mbi entitetin, ose ka një kontroll të lidhur mbi entitetin, është ortak në shoqëri, është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën entiteti është sipërmarrës, ose është një anëtar i personelit drejtues të entitetit, ose mëmës së tij (duke përfshirë familjarët e afërm të çdonjërit prej individëve të sipërpërmendur).

Gjatë vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020, shoqëria ka kryer transaksione me palët e lidhura të cilat rezultojnë në shumat e mëposhtme:

	31 dhjetor 2021		31 dhjetor 2020	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Albanian				
Green Energy	10,254,863	-	5,141,249	-
Balkan				
Green Energy	35,410,089	-	51,667,897	-
Hydra				
Energia S.R.L	-	28,631	-	29,324
Hydra				
Energia S.R.L	-	-	-	18,000,000
Giordano				
Gorini	-	-	-	2,000,000
Furnitor				
interesa	-	116,777	-	119,619
	45,664,952	145,408	56,809,146	20,148,943

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2021		31 dhjetor 2020	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Albanian				
Green Energy	56,545,774	-	33,229,046	-
Balkan				
Green Energy	79,892,119	-	51,300,523	-
San Giorgio				
Seigen spa		8,089,980		
Hydra Energia S.R.L	-	-	-	338,156
Hydra Energia S.R.L	-	118,802	-	89,324
Giordano Gorini	-	-	-	-
	136,437,893	8,208,782	84,529,569	427,480

Idro Power Service sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në Lek)

25. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

Shpërblimi total i dhënë stafit drejtues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 është 413,196 LEK (2020: 413,196 LEK).

26. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiar

mazars

Str. Emin Duraku,
B. "Binjaket" No. 5
Tirana, Albania

Tel: +355 4 2222 889
Tel: +355 4 2278 015
www.mazars.al